



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

VENDIM
Nr.4. datë 25.03.2026

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 15 datë 17.02.2020, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 25/03/ 2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 30/03/ 2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtari i Kryesisë së Këshillit
Mjaftoni ZERAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit
Dino Selimi

Anëtari i Kryesisë së Këshillit
Vladimir BAKIAJ

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Arben Gumeni





BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.4 prot.

Tepelenë, më 25.03.2026

Proces-verbal

I mbajtur sot, më datë 25.03.2026, ora 11:00, në zyrën e Këshillit Bashkiak Tepelenë, me Kryesinë e Këshillit, për të diskutuar rendin e ditës dhe për të përcaktuar datën e mbledhjes së radhës.

Marrin pjesë:

1. Arben Gumeni
2. Vladimir Bakiaj
3. Mjaftoni Zeraj

Takimin e hapi Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, i cili përshëndeti të pranishmit dhe sqaroi se mbledhja zhvillohet për miratimin e rendit paraprak të mbledhjes dhe përcaktimin e datës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak për muajin mars 2026.

Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen e radhës:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara, datë 26.02.2026.
3. Projektvendim: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fondin 6% të fondit të kushtëzuar për muajin shkurt 2026”.
4. Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin shkurt 2026”.
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e parshikimeve afatmesme të të ardhurave dhe tavaneve përgatitore të PBA 2027- 2029.”
6. **Projektvendim:** “Për miratimin e bashkëfinancimit të Bashkisë Tepelenë në programin për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë.”
7. **Projektvendim:** “Për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim, në favor të qendrës “ACEG”, një pjesë të objektit publik Shkolla 9-vjeçare “Asim Zeneli”, fshatin Progonat,

Bashkia Tepelenë, si dhe miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit që do të nënshkruhet për këtë qëllim.”

8. **Projektvendim:** “Për miratimin e marrëveshjes tip me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë.”
9. **Projektvendim:** “Për vendosjen e eshtrave të Dëshmorit të Atdheut, Mirjan Dino Hoxha, në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut të Tepelenës.”
10. **Projektvendim:** “Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Tepelenë.”
11. Çështje të tjera.
12. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Pas diskutimit, Kryesia ra dakord për rendin e ditës si më sipër dhe vendosi që mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak të zhvillohet ditën e hene në datën 30.03.2026 ora 11.00.

Mbyllet mbledhja e Kryesisë.

Kryetari i Këshillit
Arben Gumeni

Sekretari i Këshillit
Valbona Cela

KRYESIA E KËSHILLIT

Znj. Mjaftoni Zeraj
Z. Vladimir Bakiaj